



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 72/2012
Prishtinë, më 28.08.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Sala Berisha-Shala, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Izer Arifi dhe Artan Demolli-MTI; Ukë Gashi - ZPRK; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja – INDEP; Haxhi Gashi – USAID/GFSI; Lejla Selimi - OSBE dhe Nevahir Hazeri-KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.08.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit me propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-121, për mbrojtjen e konsumatorit;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.08.2012

Procesverbali nga mbledhja e datës 22 .08.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit

Kryetari – Tha se për këtë Projektligj grupi i punës ka nxjerrë disa propozimamendamente, por ende kanë mbetur për shqyrtim në mbledhje të Komisionit çështjet që kanë të bëjnë me dispozitat ndëshkuese. Më pas, fjalën ia dha kryesuesit të grupit të punës, z. Hashim Deshishkut, për t’i paraqitur amendamentet e propozuara nga grupi i punës.

Hashim Deshishku- Grupi i punës ka mbajtur disa takime, ku është shqyrtuar Projektligji nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e konsumatorit, deri te kreu XIX, te dispozita ndëshkuese apo neni 73. Ne kemi nxjerrë 54 amendamente, por te dispozita ndëshkuese jemi pajtuar si grup i punës t’i shqyrtojmë në mbledhje të Komisionit, për shkak të specifikave që mund jenë për palët e interesit, prandaj është vendosur që për këtë pjesë të Projektligjit të kemi pajtimin nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Visar Ymeri – Paraqiti vërejtje dhe propozime për disa amendamente si në vijim: **amendamenti 19**, pas fjalës “reklamuese” të shtohet teksti “nga telefonia mobile dhe posta elektronike”, sepse është më përcaktuese; **amendamenti 20**, në paragrafin dy të propozuar, të hiqet fjalia “për klientë të caktuar”, për shkak se është i panevojshëm; **amendamenti 24**, në paragrafin 1 të propozuar, të shtohet fjala “telekomunikimeve”, ndërsa në paragrafin 2 të hiqet fjalia “të telekomunikimeve dhe të tjera”, për shkak se krijohet paqartësi; **amendamenti 41**, propozoi që të ndryshohet si vijon: “Nëse kredidhënësi nuk vepron në pajtim me paragrafin 2, do të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj konsumatorit”. Sepse ky përmirësim është në frymën e dispozitës në paragrafin 1, të nenit 48.

Propozimet e z. Ymeri u përkrahen nga Komisioni.

Mezejene Selmani – Kërkoj sqarime rreth amendamentit 31 dhe 34 nga MTI-ja, për shkak të paqartësisë.

Visar Ymeri – Po ashtu, ai tha se në nenin 38, paragrafi 2.5, fjalia “ose shërbime të kohës së lirë” është e paqartë.

Izer Arifi (MTI) – Sqaroi se, kapitujt, sa i përket çështjes së instrumenteve financiare, janë transponuar drejtpërdrejt nga direktiva e BE-së.

Sala Berisha – Shala – Shtoi se pasi që vetë paragrafi i projektligjit i përjashton nga fushëveprimi i këtij ligji “kontratat” që përfliten, atëherë të hiqet paragrafi 2 i nenit 38, sepse njëjtë kemi vepruar edhe me amendamentin 26 ku është hequr neni 32.

Propozimi i znj. Berisha – Shala u përkrah nga Komisioni dhe amendamenti 31 u ndryshua me këtë përmbajtje: amendamenti 31- neni 38, paragrafi 2, hiqet.

Si pasojë e këtij ndryshimi, Komisioni hoqi edhe amendamentin 32 dhe 33, për shkak se rregullojnë të njëjtin paragraf.

Kryetari – Pasi që u miratuan amendamentet e grupit të punës, me ndryshimet e lartshënuara, ia dha fjalën deputetes, znj. Biserka Kostiq për të paraqitur propozimin e saj në lidhje me dispozitat ndëshkuese apo nenin 73.

Biserka Kostiq – Tha se, duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin në fuqi, propozoi që te neni 73 të jetë një amendament me këtë përmbajtje: neni 73, pas paragrafit 1 të shtohet një paragraf i ri 1.1 si vijon: “Nëse nuk zbatohet dispozitat e nenit 4 të këtij ligji”. Deputetja tha se nëse Komisioni nuk e përkrah këtë amendament, ajo njoftoi se do të kërkojë që të votohet në seance plenare.

Hashim Deshishku – Tha se ne duhet të marrim modelet e vendeve tjera, dhe në veçanti të rajonit dhe për këtë ftoi përfaqësuesit e shoqërisë civile të marrin fjalën, sepse e kanë bërë një hulumtim të tillë, në lidhje me këtë çështje.

Dita Dobranja (INDEP) – Tha se ne kemi hulumtuar në vendet e rajonit, por edhe të BE-së dhe më gjerë, por nuk kemi hasur në asnjë ligj që ka dispozita ndëshkuese, për shkak të mospërdorimit të gjuhëve. Ajo shtoi se këtë hulumtim e kanë proceduar në Komision.

Visar Ymeri – Tha se nuk ka nevojë për një propozim të tillë, sepse dënimet parashihen në paragrafin 3 të nenit 73, sepse aty parashihet qartë dënimi nëse nuk zbatohet neni 18 i ligjit, i cili flet për përdorimin e gjuhës.

Biserka Kostiq – Këmbënguli në propozimin e saj dhe tha se nuk është e njëjtë përmbajtja e këtij paragrafi, dallon nga gjuha shqipe në atë serbe.

Kryetari – Ne duhet të marrim modelet më të mira dhe ta tejkalojmë këtë sfidë, si dhe duhet të mendojmë që mos të ngulfatim edhe biznesin me burokraci të panevojshme. Por, sidoqoftë, do të bëjmë edhe takime shtesë me MTI-në, si dhe me faktorë të tjerë në lidhje me këtë çështje.

Për shkak të mungesës së kuorumit, Komisioni nuk mundi të nxjerrë Përfundim.

4. Të ndryshme

a) Organizimi i takimit të punës, lidhur me planin e punës së Komisionit

Kryetari – Propozoi që të formohet një grup i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, pra se cilat ligje do t'i përzgjedhim për monitorim, pasi që OSBE-ja ka shprehur gatishmëri të na përkrahë në këtë drejtim, për ta parë se sa po zbatohen ligjet e miratuara nga Kuvendi.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit